



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

NR. 7 / 6 , DATË 15 / 12 / 2020

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR
PROJEKTIN E INVESTIMIT “BERYL RESORT” ME SUBJEKTE APLIKUES
"VORTEK" SH.P.K NIPT K117080040 DHE "BEST DUTY FREE" SH.P.K NIPT
K01621002N”**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti konsiston në ndërtimin e një Hoteli me 4 Yje plus dhe njësisive akomoduese vila e apartamente, së bashku me disa ambiente shërbimi si bare dhe restorante, SPA, akademi sportive kanotazhi, mjedise sportive, çlodhëse dhe rekreacioni në një sipërfaqe prej afërsisht 10.000 m² në Fshatin Qerret, ZK 3101, Bashkia Kavajë.
- Vlera e investimit për këtë projekt parashikohet të jetë 15.519.970 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 165 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë) persona.

- Pasuritë nr. 1/535 dhe 1/536 në ZK nr. 3101, Bashkia Kavajë, të cilat preken nga ky projekt janë pjesë e fondit pyjor, në pronësi Republika e Shqipërisë, nën administrim të Bashkisë Kavajë, aktualisht objekt i dy kontratash qiraje ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjektit Vortek SHPK, respektivisht: “Kontratë qiraje ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjektit Vortek” ref ark 00005210 dhe “Kontratë qiraje ndërmjet Bashkisë Kavajë dhe subjektit Vortek” ref ark 00005210.
- Pasuritë që preken nga projekti përfshihen në tre zona dhe konkretisht: G2-A 12-01 (zonë për përmirësim dhe plotësim); G2-A1 1-01 (zonë vetëm për aktivitete rekreative); N143 (zonë natyrore pyjore).

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Beryl Resort”, me subjekte investues “Vortek” sh.p.k NIUS K11708004O & “Best Duty Free” sh.p.k. NIPT K01621002N”, Fshati Qerret, ZK 3101, Bashkia Kavajë në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. ‘Referuar ‘Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Turizmit’ si dhe dokumentave të tjerë në fuqi për planifikimin dhe rregullimin e territorit, modeli i propozuar i projektit të investimit “Beryl” nuk përputhet me modelin e miratuar në këto akte për një zhvillim cilësor të industrisë së turizmit në përputhje me treguesit që zonat me përparësi zhvillim turizmi (ZPZHT) parashikojnë.
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare

e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA